



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më **30.12.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSBB-së, Nënkryetarin Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të Policisë në Rahovec z. Fazli Morina, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë e që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSBB-së, OSBE-së, përfaqësuesit e klerit fetar, shefin e ZKKK-së z. Lendrit Qeli, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i shtatë për vitin 2019 i KKSBB-së. Të pranishëm janë 22 anëtarë të KKSBB –së. Për këtë mbledhje propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë,
 - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik,
3. Të ndryshme.

Kryetari – Ky rend dite, po ju vë në dijeni, është në përputhje me planin e KKSBB-së për vitin 2019, nëse nuk ka ndonjë koment për ndonjë pikë të rendit të ditës, atëherë e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo e vë në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari- Kam dy fjalë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në komunën tonë, sigurisht pastaj do të adresohet më konkretisht edhe Komandanti i Stacionit të Policisë, kapiteni Fazli Morina edhe gjithë të tjerët. Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës të mbledhjes së KKSBB-së, rreth situatës së sigurisë në gjithë territorin e komunës së Rahovecit, nga zyrtarët përgjegjës marrim raporte në kohë reale, si nga Policia e Kosovës stacioni në Rahovec, bazuar në ato raporte në periudhën 40 ditore që nga mbledhja e kaluar nuk kemi parë diçka që e cenon sigurinë në komunën e Rahovecit dhe mund të them se situata e sigurisë është pozitive, e qetë, stabile dhe e qëndrueshme. Ne, si komunë kemi

marrë një vendim për mos përdorimin e mjeteve piroteknike, posaçërisht në ato vende ku ka qarkullim të madhe të njerëzve.

Fazli Morina, Komandant i Stacionit policor në Rahovec – Përshëndetje Kryetar për ju personalisht, përshëndetje për gjithë pjesëmarrësit në sallë duke i përfshirë gjithë anëtarët e KKSB-së. Së pari falënderoj Kryetarin për bashkëpunimin e treguar me Policinë e Kosovës në vitin 2019, sa i përket sigurisë së përgjithshme konstatoj se gjendja e sigurisë për periudhën 40 ditore të fund vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile. Ajo që është shqetësuese është se dhuna në familje është duke u rritur çdo ditë, pra, nuk kemi zvogëlim të dhunës në familje por kemi rritje të dhunës. Po ashtu, ajo që vlen të ceket për këtë periudhë është rastet e dy grabitjeve, njëra në IPKO dhe tjetra në bankën BKT, që të dyja në qytetin e Rahovecit, ky rast tani ka kaluar në njësinë e hetimeve të Gjakovës. Kurse sa i përket përdorimit të mjeteve piroteknike, ky fenomen është duke vazhduar ende dhe për neve është mjaftë shqetësues sepse vetë prindërit janë duke i dhënë fëmijëve të tyre para për t'i blerë këto mjete piroteknike. Pra së pari duhet të vetëdijesohen familjarët e fëmijëve se ato janë mjaftë të rrezikshme.

Sa i përket lirimit të trotuareve, kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese edhe pse në qytetin e Rahovecit ka mjaftë parkingje, por vozitësit përsëri janë duke i parkuar makinat e tyre vend e pa vend.

Arben Bikiqi - Përfaqësuesi i FSK-së – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, FSK-ja është duke mbajtur ligjëratat nëpër shkollat e Republikës së Kosovës sa i përket vetëdijesimit për mos përdorim të mjeteve piroteknike, por për fat të keq në këtë projekt nuk është i përfshirë qyteti i Rahovecit. Prandaj besoj se në të ardhmen do të jenë të përfshirë edhe shkollat e Komunës së Rahovecit, por përderisa nuk janë të përfshirë, kishte me qenë mirë që DKA-ja të angazhohet që ti mbaj nëpër shkollat e komunës së Rahovecit ligjëratat e këtij lloji.

Fadil Sylka – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, a ka mundësi që një patrullë e policisë të qarkullojë gjatë ditës në rrugën kryesore të qytetit, posaçërisht nga semaforët e deri te Stacioni i Autobusëve, sepse te kjo pjesë kemi pengesë të madhe edhe në qarkullim të rregullt të automjeteve por edhe të këmbësoreve.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket përdorimit të mjeteve piroteknike mendoj se në Kosovë kjo është bërë si tradicionale gjatë festave, por mendoj se përdorimi i tyre duhet të bëhet në vendet e caktuara e jo vend e pa vend. Prandaj këtu duhet të ndërhyjnë prindërit e atyre fëmijëve që t'i tregojnë se këto mjete nuk duhet përdorur vend e pa vend, sepse nga ta mundemi të kemi edhe pasoja negative.

Ymret Reshiti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, po ju njoftoj që kam pasur një takim me shefin e Task Forcës për antidrogë dhe siguri në shkolla në nivel të Kosovës, deri te kjo Task Force ka ardhur për arsye se angazhimet për vitet e tëra në luftën kundër antidrogës dhe sigurisë në shkolla nuk ka qenë e realizuar shumë nga MPB. Kapacitetet kanë qenë të pamjaftueshme, prandaj është kërkuar një gjithë përfshirje më e madhe, prandaj Kryeministri në këtë Task Force ka kyçur edhe ministrinë e tjera dhe akterë tjerë ndihmës. Mua më ka kërkuar z. Abdullah Hasani edhe mbështetjen e prindërve sepse sipas vlerësimeve që janë bërë prindërit munden të japin shumë kontribut në luftimin e përdorimit të antidrogës dhe sigurisë në shkolla. Nga viti i ardhshëm do të ketë edhe fushatë nëpër komuna nga kjo Task Force, ku do të kërkohet edhe përkrahja e komunave.

Shani Sylka – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Kamerat e sigurisë që janë instaluar në disa vende në qytet nuk janë funksionale, kërkoj nga organet përgjegjëse që të funksionalizojnë këto kamera, po ashtu kishte me qenë shumë mirë që të shtohen ende kamerat e sigurisë në vende kyçe në qytetin e Rahovecit.

Fazli Morina – Të nderuar, njësitet e Stacionit Policor në Rahovec janë të angazhuar në maksimum, gjithmonë duke i marrë parasysh personelin, mundësitë dhe logjistikën që e kemi. Sa i përket rrugës kryesore, i nderuar, tani duke pasur parasysh ardhjen e bashkëqytetarëve tanë nga jashtë qarkullimi i automjeteve është rritur 100 %, është e vërtetë që ka bllokadë të qarkullimit por bllokadën e shkaktojmë ne vetë qytetarët, ne nuk kemi mundësi çdo metër me e vendos nga një polic, pra duhet ne vetë si qytetarë apo si vozitës të vetëdijesohemi. Po ashtu, unë kam kërkuar disa herë që edhe ato parkingje që janë të lejuar në qendër të qytetit të anulohen të gjitha sepse aty është tmerr, besoj se e

keni parë vetë që disa herë ka ndodhur shkaktimi i rreth rrotullimit. Në qendër parkohen më shumë se dy radhë me automjete dhe kjo e vështirëson pastaj kyçjen në rreth të ndonjë mjeti më të madh. Sa i përket kamerave të sigurisë këto që janë për momentin të instaluara në qytet nuk janë funksionale, kurse pe marr një shembull Malishevën atyre i funksionojnë shumë mirë kamerat e sigurisë dhe ata nuk kanë pasur asnjë rast siç po na ndodhin neve kohëve të fundit. Kurse ne duhet të shkojmë nëpër lokale private dhe shtëpi private t'i lusim që të na lejojnë t'i shikojmë kamerat private, e di që Kuvendi Komunal e ka filluar një iniciativë me UNMIKUN, por nuk e di se deri ku kanë mbërritur me procedura.

3. Të ndryshme.

Lulëzim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Të nderuar, Nazif Krasniqi nga fshati Zatriq i Komunës së Rahovecit, e ka gjendjen ekonomike shumë të vështirë. Unë së bashku me një koleg timin kam qenë ta vizitoj atë në shtëpi, aty ku jeton ai, lirishtë mund të themi se ajo nuk ishte shtëpi, ajo shtëpi nuk i plotëson as kushtet minimale për të jetuar aty. Po ashtu z. Nazif është i sëmurë nga astma dhe qëndrimi në atë shtëpi vetëm sa e rëndon gjendjen e tij shëndetësore. Personi i cili ka qenë me mua ta vizitoj Nazifin ka shprehur dëshirën që t'ia ndërtoj shtëpinë pa ndihmën e askujt vetë ai me mjete të veta personale. Ne kërkojmë nga Kryetari i Komunës që të na gjejë një parcelë deri në 3 ari në qytet dhe si të na gjejë parcelën, donatori do ja filloj me ndërtimin e shtëpisë.

Shani Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një njoftim dhe një falënderim. Jam përfaqësues i sektorit C të KLSP-së, njoftim për faktin se ka përfunduar projekti i rrethimit fushës së edukatës fizike dhe dyerve të oborrit të shkollës fillore “Rilindja” në fshatin Çifllak. Me këtë rast falënderojmë të gjithë ata që na ndihmuan që ta realizojmë këtë projekt si OSBE-ja, Ambasada e Norvegjisë, përfaqësuesit e KLSP-së nga sektori C, zyrtarët policor nga stacioni i Rahovecit dhe komunën e cila e ka mbështet projektin me 15% të vlerës.

Kryetari – Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, tani do i nxjerrim disa konkluzione sa i përket kësaj mbledhje:

Sa i përket përdorimit të mjeteve piroteknike mendoj se duhet të ndërmerret vetëdijesimi shtesë te qytetarët sa i përket përdorimit të mjeteve piroteknike, kjo duhet të bëhet nga institucionet si policia, institucionet komunale po ashtu edhe nga vetë banorët dhe kryefamiljarët.

Parkingje- kërkoj nga inspektorët komunal dhe policia të jenë më të mobilizuar, të marrim masa shtesë për mosparkim të automjeteve në vendet e ndaluara, tani për fat të mirë e kemi edhe auto merimangën dhe ju lutem që të përdorni atë.

Sa i përket ekspozimit të mallit nëpër trotuare dhe vendet e ndaluara, kërkoj nga Inspektorati i komunës që menjëherë që tani të ndërmerr masa konformë ligjit, të bëhet konfiskimi i mallit. Ne disa herë i kemi paralajmëruar këta shkelës të ligjit, por ata përsëri janë duke vazhduar me të vjetrën, pra janë duke e sfiduar ligjin.

Rreth ligjëratave në shkolla nga ana e FSK-së- i nderuar, komuna e Rahovecit që tani është e gatshme që të bashkëpunojë me FSK-në, prandaj kërkoj nga DKAQ-ja që të bie në kontakt me përfaqësuesit e FSK-së që në vitin 2020 ky bashkëpunim të jetë i arritur.

Kurse sa i përket kamerave të sigurisë besoj se brenda 3 muajve të fillim vitit 2020 duhet të gjenden mjetet për realizimin e projektit të kamerave.

Gjithashtu në momentin që do të sigurojmë pronën për të nderuarin z. Nazif Krasniqi, ne do t'i lajmërojmë donatorit që t'ia filloj ndërtimin e shtëpisë edhe pse kjo do të jetë pak e vështirë. Po ashtu ne jemi duke e ndërtuar një shtëpi për pleq për qëndrim ditor, ku do ju sigurojmë edhe transport falas për shkuarje dhe ardhje deri tek kjo shtëpi, kurse sa i përket plotësimit të kushteve për njerëz me nevoja të veçanta, ne do të shikojmë mundësitë që i kemi në disa objekte që janë në qytetin e Rahovecit, si objekti i shoqatës “Hareja” ose objekti i SHHL – Kosova, nëse ka mundësi që të shfrytëzohen për personat me nevojë të veçantë.

Faleminderit edhe një herë të gjithëve për kontributin e dhënë, urime festat e fund vitit, qoftë një vit i gëzuar dhe i suksesshëm, të keni shëndet dhe gëzime në familjet tuaja në vitin 2020, po ashtu qoftë një vit më i mirë se sa viti 2019. Sukses dhe mbarësi deri në mbledhjen e ardhshme të vitit të ardhshëm e punë të mbarë!

Mbledhja përfundoi në 11:30

Procesmbajtësi

Skender Hamza

